# Thjeshtë, shpejt dhe digjital:
# Regjistrimi në Kita në vetëm katër hapa

**Nëpërmjet Website der Stadt Mülheim an der Ruhr ju keni akses online në ofertat e përkujdesjes për fëmijë në Kita-t (institucionet ditore të fëmijëve) të qytetit të Mülheim-it. Ju mund të regjistroheni me vetëm pak klikime dhe mund ta transmetoni nevojën tuaj (për deri në 10 Kita) online.**

## 1 Informimi

- Një listë të Kita-ve dhe qendrave familjare në Mülheim an der Ruhr ju merrni këtu: https://geo.muelheim-ruhr.de/kindergaerten
- Në hartë ju e shikoni vendndodhjen e institucioneve përkatëse (Kita-t).
- Ju mund ta filtroni kërkimin tuaj për shembull sipas mbartësve (ofruesve), lagjeve ose sipas vëllimit të përkujdesjes.
- Klikoni në emrin e një institucioni në tabelën poshtë hartës. Ju merrni informacione të tilla si adresën, orarin e hapjes, personat e kontaktit dhe informacione të tjera, për shembull për konceptin pedagogjik të Kita-s.

**Koncepti pedagogjik? Ai i përshkruan metodat dhe parimet, sipas të cilave organizohet arsimi dhe shoqërimi i fëmijëve në një Kita. Për shembull sipas një parimi të hapur, i cili dëshiron t'i nxisë potencialet e fëmijëve.**




## 2 Regjistrimi

- Regjistrohu në këtë faqe interneti: https://kitaanmeldung.muelheim-ruhr.de
- Nëse ju nuk keni akoma një llogari përdoruesi, klikoni në **„Neues Benutzerkonto erstellen"** ("Krijimi i një llogarie të re të përdoruesit"). Po të keni krijuar tashmë një llogari përdoruesi, hyni brenda.
- Plotësoni të gjitha fushat me një yll të kuq *. Klikoni pastaj në **„Absenden"** ("Dërgo").
- Nëse paraqitet një mesazh në një kuti jeshile, regjistrimi ka qenë i suksesshëm. Njëkohësisht ju merrni një e-mail që e përmban emrin tuaj të përdoruesit. Tani ju mund të hyni brenda me emrin tuaj të përdoruesit dhe me fjalëkalimin tuaj në **kitaplus-Startseite**.






## 3 Futni të dhëna

- Plotësoni fillimisht nëpërmjet butonit **„Kontaktdaten“** (“të dhënat e kontaktit“) të dhënat tuaja, si prindër ose persona me të drejtë edukimi.

- Mbushni për këtë plotësisht fushat me të dhënat tuaja personale dhe klikoni në fund në **„Eingabe speichern“** (ruani të dhënat e futura).




- A ka një prind të dytë ose një person tjetër me të drejtë edukimi? Nëse po, klikoni në përpunimin e **„2. Erziehungsberechtigten bearbeiten“** (“personit të 2-të me të drejtë edukimi“). Nëse jo, klikoni në **„Anmeldung Kinder“** (“regjistrimi i fëmijëve).




- Nëse të gjitha të dhënat për prindërit janë futur dhe ruajtur, vazhdoni me të dhënat për fëmijën tuaj. Klikoni për këtë në **„Neues Kind anlegen“** (“krijoni rubrikën ‚Fëmijë të ri‘“).






- Mbushni fushat me të dhënat për fëmijën. Me një klikim në **„Anschrift … übernehmen“** (“Marrja e të njëjtës adresë…“) të dhënat tuaja si prindër pranohen automatikisht për fëmijën tuaj.



## 3 Futni të dhëna

- A keni futur të gjitha të dhënat në mënyrë korrekte? Ruajini të dhënat nëpërmjet butonit **„Eingaben speichern“** (“ruani të dhënat e futura“).




- Paraqitet një konfirmim që të dhënat janë ruajtur me sukses.






**Ju dëshironi të regjistroni një fëmijë tjetër? Klikoni në „Neues Kind anlegen“ dhe përsëriteni procedurën**

## 4 Pararegjistroni fëmijën

- Për ta pararegjistruar fëmijën për deri në 10 Kita-t, klikoni në butonin **„Voranmeldung Kind(er)“** (“pararegjistrimi i fëmijës (fëmijëve)“). Zgjidheni emrin e fëmijës suaj që dëshironi të pararegjistroni Pastaj klikoni në **„Neue Einrichtung(en) hinzufügen“** (“Shtoni institucione të reja“).




- Paraqitet një listë e të gjitha institucioneve, në të cilat është i mundshëm një regjistrim online. Shënojini Kita-t e dëshiruara. Klikoni në butonin **„Neue Auswahl hinzufügen“** (“shtoni një përzgjedhje të re“) në fund të faqes.






# 4 Pararegjistroni fëmijën

- Përzgjedhja juaj tregohet në një tabelë të re. Klikoni tek çdo Kita mbi përpunimi (✎ simboli i lapsit). Zgjidheni kohën e dëshiruar të përkujdesjes prej 35 ose 45 orësh. Ndryshoni, nëse është e nevojshme, datën e dëshiruar të pranimit. Klikoni në **„Eingaben speichern“** (ruani të dhënat e futura).



Einrichtungsauswahl für Jona Kl

| Einrichtung | Aufnahme-wunsch | Betreuungs-wunsch | Geschwister-kind | Alters-klasse | Optionen | Status |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fiedelbär | Bitte eintr... | Bitte eintragen | | | | unvollständig |
| Pööstekiste | Bitte eintr... | Bitte eintragen | | | | unvollständig |
| Rappelkiste | Bitte eintr... | Bitte eintragen | | | | unvollständig |
| Fantadu | Bitte eintr... | Bitte eintragen | | | | unvollständig |
| Burg Wackelzahn | Bitte eintr... | Bitte eintragen | | | | unvollständig |
| Bärenhöhle | Bitte eintr... | Bitte eintragen | | | | unvollständig |

- Të gjitha institucionet paraqiten me një semafor të verdhe. Vetëm tani paraqitet poshtë butoni **„Anmeldedaten abschließend kontrollieren und freigeben“** ("Më në fund kontrolloni dhe miratoni të dhënat e regjistrimit").
  Klikoni mbi këtë buton. Paraqitet një pasqyrë e përgjithshme me të gjitha të dhënat për prindërit, fëmijët si dhe për institucionet (Kita-t) e zgjedhura.

  A janë të sakta të dhënat tuaja?
  Korrigjimet janë të mundshme nëpërmjet butoni **„Kontaktdaten“** ("të dhënat e kontaktit").
  Më vonë, nuk janë më të mundshme ndryshimet në portal. Në rast të ndryshimeve të të dhëna ve tuaja (për shembull për shkak të shpërnguljes) ju duhet t'i kontaktoni qendrat e veçanta ditore të fëmijëve dhe duhet t'i informoni këto mbi ndryshimet.

- Merrni në dijeni **„Datenschutzerklärung“** (deklaratë për mbrojtjen e të dhënave").
  Vendosni për këtë një çengel.

- Klikoni pastaj mbi butonin **„Anmeldung durchführen“** ("kryeni regjistrimin").
  Të dhënat tuaja transmetohen

- Semafori në statusin tuaj duhet të ndriçojë që tani jeshil („parashtruar").
  Një skedar PDF mund të kërkohet dhe e konfirmon regjistrimin tuaj.



**Ju lutemi, vini re se ky regjistrim nuk është akoma një pohim! Që nga ky moment ju jeni në listat e pritjes së institucioneve tuaja të dëshiruara.**

Vendet ndahen në periudhën nga janari deri në mars.
Nëse ju nuk keni marrë asnjë ofertë për një vend, ju lutemi drejtojuni stafit në Seksionin për fëmijë, rini, shkollën dhe integrimin nën numrin e **telefonit: 0208 / 455 45 55**, **e-mail:** kinderbetreuung@muelheim-ruhr.de



Amt für Kinder, Jugend, Schule und Integration
Mülheim an der Ruhr
Kommunales Integrationszentrum

Gefördert durch:

Kommunales INTEGRATIONS Management NRW

Ministerium für Kinder, Jugend, Familie, Gleichstellung, Flucht und Integration des Landes Nordrhein-Westfalen